

URDHËR
Nr. 251/1, datë 27.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d” të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 31.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe të pikës 3, të nenit 15 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron z. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, z. Pëllumb Abeshi.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga z. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve duke filluar nga data 27.7.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Alqi Bllako, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Ministrinë e Mjedisit, z. Pëllumb Abeshi.

4. Urdhri nr. 251, datë 27.7.2017, me përmbajtje “Për delegim kompetence”, i Ministrit të Mjedisit, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka